



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RREGULLORE

MBI

**FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E DETAJUAR TË INFORMIMIT TË KREDITORËVE
TË NJOHUR TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 56, datë 29.03.2018

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat në lidhje me formën dhe përmbajtjen e detajuar të informimit të kreditorëve të njohur të shoqërisë së sigurimit në rastet e likuidimit të detyrueshëm.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 177 pika 3, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Terminologjia dhe përkufizimet

1. Përkufizimet dhe terminologjia e përdorur në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, zbatohet edhe për këtë rregullore.
2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, kreditori është “kreditor i njohur”, nëse shoqëria e sigurimit/likuidatori provon me anë të dokumenteve ose rrethanave të arsyeshme që ai është kreditor.

3. Për qëllimet e kësaj rregulloreje termi:

- a. “Kreditor” nënkupton “kreditor i njohur”;
- b. “Shoqëri sigurimi” nënkupton “shoqëri sigurimi dhe/ose degë e vendit të huaj/anëtar”;
- c. “Ligj” nënkupton Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 4

Publikimi për hapjen e likuidimit të detyrueshëm

1. Vendimi për hapjen e likuidimit të detyrueshëm publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë së sigurimit, si dhe në faqen zyrtare të AMF-së.
2. Vendimi i hapjes së procedurave të likuidimit të detyrueshëm për shoqërinë e sigurimit përmban gjithashtu informacionin që AMF është autoriteti kompetent, emrin dhe adresën e likuidatorit të emëruar nga Autoriteti, si dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me procedurat e likuidimit.
3. Në rastin e publikimit të vendimit të hapjes së procedurave të likuidimit të detyrueshëm për degën e vendit huaj/anëtar zbatohen dispozitat e Rregullores nr. 54, datë 26.05.2017 “Mbi likuidimin e detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit, të një vendi të huaj dhe një vendi anëtar të BE-së”.

Neni 5

Njoftimi i kreditorëve të njohur

1. Likuidatori i emëruar nga Autoriteti në përputhje me nenin 176, pika 1, të Ligjit informon menjëherë me shkrim të gjithë kreditorët e njohur në lidhje me hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm.
2. Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, ju dërgohet të gjithë kreditorëve, secilit në mënyrë individuale.
3. Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, ju dërgohet gjithashtu edhe kreditorëve që kanë vendbanimin ose selinë e tyre jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Përmbajtja e njoftimit me shkrim

Njoftimi me shkrim i përmendur në nenin 4 të kësaj rregulloreje, përveç informacionit të parashikuar në nenin 177 të Ligjit, përfshin gjithashtu edhe informacionin e mëposhtëm:

- a. Të dhëna në lidhje me hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm;
- b. Datën kur vendimi i hapjes së procedurave të likuidimit të detyrueshëm hyn në fuqi;

- c. Datën brenda së cilës kreditori duhet të paraqesë pretendimin e tij me shkrim ose të paraqesë ndonjë vërejtje me shkrim në lidhje me vlerën e tij të pretenduar;
- ç. Çështjet që duhet të përfshihen në kërkesën për pretendim të kreditorit;
- d. Efektet juridike që sjell hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm në lidhje me kontratën e sigurimit për sa i përket kërkesave për dëmshpërblim të kreditorit.

Neni 7

Formati dhe gjuha e njoftimit me shkrim

- 1. Format i njoftimit me shkrim në mbështetje të neneve 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje hartohet sipas Shtojcës 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
- 2. Njoftimi me shkrim i kreditorëve të njohur dërgohet në gjuhën shqipe dhe/ose në gjuhën angleze në rastin e kreditorëve jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 3. Njoftimi i kreditorëve të njohur përveç se në adresën postare të kreditorit dërgohet, nëse është e mundur edhe në adresën e tij të e-mailit.

Neni 8

E drejta për të ngritur pretendime

Çdo kreditor i një shoqërie sigurimi, person fizik apo juridik, duke përfshirë edhe autoritetet publike, që ka vendbanimin ose selinë brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të depozitojë pretendime ose të paraqesë vërejtje me shkrim në lidhje me vlerën e tij të pretenduar.

Neni 9

Kërkesa për pretendim

Në mbështetje të nenit 6, germa ç, të kësaj rregulloreje kreditori duhet të paraqesë kopje të dokumenteve mbështetëse që vërtetojnë si më poshtë:

- a. Natyrën e pretendimit;
- b. Datën në të cilën ka lindur e drejta për këtë pretendim;
- c. Shumën e pretendimit;
- ç. Nëse pretendimi ka përparësi apo jo.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA 1

NJOFTIMI I HAPJES SË PROCEDURAVE TË LIKUIDIMIT TË DETYRUESHËM PËR SHOQËRINË E SIGURIMIT _____

Njoftimi i kreditorëve të njohur në lidhje me hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm për shoqërinë e sigurimit _____

EMRI I SHOQËRISË	Shoqëria e sigurimit _____
DATA DHE HYRJA NË FUQI E VENDIMIT PËR LIKUIDIM	
EFEKTET JURIDIKE TË VENDIMIT NË LIDHJE ME KONTRATAT E SIGURIMIT/ TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KREDITORËVE NË LIDHJE ME KONTRATËN NË FJALË	
AFATET KOHORE PËR DEPOZITIMIN E PRETENDIMEVE/VËREJTJEVE	
PASOJAT NË RAST TË MOSDEPOZITIMIT NË KOHË TË PRETENDIMEVE/VËREJTJEVE	
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KREDITORËVE GJATË LIKUIDIMIT/RADHA E PRETENDIMEVE	
AUTORITETI PÛRKATËS KU DEPOZITOHEN PRETENDIMET	
ÇËSHTJET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË KËRKESËN PËR PRETENDIM TË KREDITORIT	
NJOFTIME TË ARDHSHME	
LIKUIDATORI I EMËRUAR	Emër Mbiemër Adresa Tel:

	Fax: Email:
--	----------------